

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Referuar vendimit Nr.648/2021 të Komisionit të prokurimit Publik (KPP-së)

Për: **“Blueprint Technologies” sh.p.k** me Nr.Nipti: **L82428011G** me adresë: TIRANE
Njesia Administrative nr. 10, Rruga "Fortuzi", Nr. 66/1

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, prokurim me mjete elektronike –
shërbime me numër **REF-99456-06-29-2021**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Materiale për Funksonimin e Pajisjeve të Zyrave”**

Fondi limit 1,208,000 (një milion e dyqind e tetë mijë) **lekë pa TVSH**

Burimi i Financimit: vënë në dispozicion nga Buxheti i Tirana Parking, miratuar me V.K.B.
Nr.172 datë 21.12.2020 të Këshillit Bashkiak të Tiranës “Për miratimin e programit
buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin
2021”

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 10 (dhjetë) ditë duke nisur nga
data e lidhjes së kontratës

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **12.07.2021, ora 11:00**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në këtë procedurë këta ofertues me vlerat
përkatëse të ofruara:**

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

1.Operatori ekonomik “COLOMBO” sh.p.k

K36608208V

Çmimi total i ofertës është **984,000** (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë) **lekë pa TVSH.**

2.Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k

L82428011G

Çmimi total i ofertës është **948,100** (nëntëqind e dyzet e tetë mijë e njëqind) **lekë pa TVSH.**

3.Operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k

J62426002Q

Çmimi total i ofertës është **1,050,657** (një milion e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH.**

4.Operatori ekonomik “LUAR Bros” sh.p.k

L72322004M

Çmimi total i ofertës është **1,365,500** (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH.**

5.Operatori ekonomik “PC STORE” sh.p.k

L01606034A

Çmimi total i ofertës është **1,185,200** (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind) **lekë pa TVSH.**

1.Eshtë shqyrtuar oferta e paraqitur nga ofertuesi “COLOMBO” sh.p.k

Çmimi total i ofertës është **984,000** (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë) **lekë pa TVSH.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi hapi shpalljet e ofertave, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së ofertuar në këtë procedurë prokurimi rezulton se:

- Nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim të përcaktuara në DT për arsyet e mëposhtme:
 - Nuk ka plotësuar Shtojcën 1 Formulari i Ofertës.
 - Nuk ka plotësuar Shtojcën 2 Lista e Çmimeve të Artikujve.
 - Nuk ka plotësuar Shtojcën 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.
- Nuk plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DT për arsyet e mëposhtme:
 - Nuk përmbush kriterin tek Shtojca 7, pika 2.3 Kapaciteti Teknik, nën-pika 2.3.2: “*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalent*” dhe çertifikata ISO 9001:2015 me kodin SISTEMA/ALB/0721Q111 e paraqitur në tender, nuk është e vlefshme pasi është lëshuar nga një trupë certifikuese që nuk është e akredituar në Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.
<http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>
- Është paraqitur grafiku i lëvrimet sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike.
- Gjithashtu në momentin e hapjes së ofertave, operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat për zërat e mëposhtëm:
 - LexMark CX 310 dn mag 80C2SM0

- LexMark CX 310 dn yellow 80C2SY0
- Samsung Xpress SL-C480W cyan CLT-C404S
- Samsung Xpress SL-C480W mag CLT-M404S

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu X neni 82, pika 3, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta **nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit referuar listës së kërkesave të tenderit të shpallur në sistemin elektronik të APP

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92, pika 3 Kreu XI të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 dt 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2, e shpall **të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomik **“COLOMBO” sh.p.k** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

2. Eshtë shqyrtuar oferta e paraqitur nga ofertuesi **“LUAR BROS” sh.p.k**

Çmimi total i ofertës është **1,365,500** (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DT për arsyet e mëposhtme:
Oferta është mbi vlerën e përcaktuar në fondin limit të përcaktuar në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.
- Është paraqitur grafiku i lëvrimit sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Oferta Ekonomike e OE **“LUAR BROS”sh.p.k** është më e lartë se Fondi Limit i përcaktuar për këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92, pika 3 Kreu XI të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 dt 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2, e shpall **të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomik **“LUAR BROS” sh.p.k** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

3. Eshtë shqyrtuar oferta e paraqitur nga ofertuesi **“INFOSOFT OFFICE” sh.p.k**

Çmimi total i ofertës është **1,050,657 leke** (një milion e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DT për arsyet e mëposhtme:
 - Nuk perbush kriterin tek Shtojca 7, pika 2.3 Kapaciteti Teknik, nenpika 2.3.2: “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalent” dhe konkretisht Certifikata ISO 9001:2015 me nr AQS/Q/69852021 e paraqitur nuk rezulton të jetë lëshuar nga trupa certifikuese <http://aqscert.org/#online-aqs-form>
- Është paraqitur grafiku i lëvrimit sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu X neni 82, pika 3, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta **nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit referuar listës së kërkesave të tenderit të shpallur në sistemin elektronik të APP

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92, pika 3 Kreu XI të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 dt 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2, e shpall **të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomik “**INFOSOFT OFFICE**” **sh.p.k** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

4.Është shqyrtuar oferta e paraqitur nga ofertuesi “PC STORE” sh.p.k

Çmimi total i ofertës është **1,185,200** (një milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind) **lekë pa TVSH.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi hapi shpalljet e ofertave, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së ofertuar në këtë procedure prokurimi rezulton se :

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DT.
- Është paraqitur grafiku i lëvrimit sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII neni 66, pika 4, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92, Kreu XI të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e

operatorit ekonomik .“PC STORE” sh.p.k është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të vlefshme**.

5. Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “BLUEPRINT TECHNOLOGIES” sh.p.k

Çmimi total i ofertës është **948,100** (nëntëqind e dyzetë e tetë mijë e njëqind) **lekë pa TVSH**.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DT.
- Është paraqitur grafiku i lëvrimit sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII neni 66, pika 4, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92, Kreu XI të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik .“BLUEPRINT TECHNOLOGIES” sh.p.k është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të vlefshme**.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 93, Kreu XI të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” , VKM Nr.285 dt 19.05.2021 Kreu X, Neni 82, pika 4 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” vlerëson në bazë të formulës së parashikuar në dokumentat e tenderit nëse oferta është apo jo anomalisht e ulët.

Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në VKM Nr.285 dt 19.05.2021 Kreu X, Neni 82, pika 4 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Nga shqyrtimi që ju është bërë dokumentacionit të operatoreve ekonomike të paraqitur rezultoi vetem 1 një oferte e vlefshme dhe rrjedhimisht përdoret formula e mëposhtme:

*“Në rastin kur janë të vlefshme **dy ose më pak** oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.”*

Fondi limit është **1,208,000** (një milion e dyqind e tetë mijë) **lekë pa TVSH**.

Oferta “BLUEPRINT TECHNOLOGIES” sh.p.k = **948,100** (nëntëqind e dyzetë e tetë mijë e njëqind) **lekë pa TVSH**

75% i Fondit Limit = 75% x 1,208,000 = 906,000(nëntëqind e gjashtë mijë) **Lekë pa TVSH**.

Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezultoi se oferta e paraqitur e vlefshme nuk është anomalisht e ulët në bazë të nenit 93, Kreu XI të Ligjit nr.162, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”

Për sa më sipër, pas shqyrtimit të hollësishëm të veprimeve të kryera, gjatë procedurës së prokurimit, duke u ballafaquar me dokumentat e tenderit, si dhe detyrimet ligjore për prokurimet publike, është arritur në konkluzionin, se oferta e paraqitur dhe e dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik nga operatori ekonomik, është e pranueshme dhe e vleshme të kualifikohet, mbasi është në përputhje me kërkesat e ligjit të prokurimeve, plotëson kërkesat administrativo-ligjore dhe specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit të Autoritetit tonë Kontraktor.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e Operatorit Ekonomik **“BLUEPRINT TECHNOLOGIES” sh.p.k.** me adrese TIRANE Njesia Administrative nr. 10, Rruga "Fortuzi", Nr. 66/1, me vlerë **948,100** (nëntëqind e dyzetë e tetë mijë e njëqind) **lekë pa TVSH** është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Referuar Kreut XI, Nenit 82, pika 5 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” OE fitues duhet të dorëzojë dokumentat provuese për vetdeklarimet sipas formularit përmbledhës të vetdeklarimit (shtojca Nr.8 e DST-së) si dhe dokumentat e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Dokumentat duhet të jenë origjinal ose kopje të njësuara me origjinalin.

Ankesa.Ka pasur

Kthyher përgjigje më datë 02.08.2021